



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-5392/20
Kaçanik, 28.02.2020

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **II (Dytë)** e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2020 (Legjislatura e VI-të), mbajtur me 28 Shkurt 2020. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 13:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarëve të KK, pjesëmarrës në mbledhje ishin fillimisht 25 anëtarë, në ndërkohë erdhi edhe anëtarja Lirije Luta, kështu që konstatohet së pjesëmarrës të kësaj mbledhje ishin 26 anëtarë. Në mbledhje mungoj me arsye, anëtari Bekim Koxha.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, drejtorët e drejtorive komunale: Ukshin Qallaku, Ramadush Osmani, Fatmir Loku, Bahri Selimi, Diana Reka, Festim Neziraj dhe Zahir Doda, ndërkaq nga zyrtarët e komunës: Bejtulla Dalloshi, Hidajete Guri dhe Ilirijana Berisha.

Nga strukturat tjera ishin, zyrtare ligjore nga Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe zyrtari ligjor i komunës së Hanit të Elezit, njëherë Kryesues i Kolegjiut të Zyrës ligjore në AKK. Nga OSBE, mbledhjen e monitoroj, Gazmend Murseli.

Nga strukturat vendore, mbledhja monitorohet përmes, Teleprezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MAPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës, Makfirë Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndeti të gjithëve, iu uroj mirëseardhje. Fillimisht u kërkoj falje që mbledhja është shtyrë për dy orë për shkak të manifestimit përkujtimor në f. Gajre Në vazhdim konstatoj kuorumin duke i thirrur emër për emër të gjithë anëtarët e KK, prezent në mbledhje janë për momentin 25 anëtarë, një anëtar vjen në ndërkohë, ndërkaq anëtari Bekim Koxha mungon me arsye për shkak së ka rast vdekje në familje. Kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e II të Rregullt të Kuvendit të Komunës, data 28 Shkurt 2020, me këtë rend pune:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Propozim Rregullor për Taksat Komunale;
3. Raporti i Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2019;

4. Raport (Informatë) i punës së Njesisë së Personelit për periudhën: Janar-Dhjetor 2019;
5. Raporti Vjetor Financiar për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2019;
6. Raporti i Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2019;
7. Raporti i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2019; dhe
8. Propozim Vendimi për ndryshim plotësimin e vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 60/01-36810/19 të datës 29.11.2019.

Lidhur me rendin e punës e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e propozuar të punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

Aprovoj

Rendin e Punës në përbërje prej 8 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

2. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, nëse ka kush ndonjë vërejtje lë të urdhëroj:

z. Shemsedin Luzha, Të pozicioni i pyetjeve dhe kërkesave, pyetjeve të mia, pyetja me nr.1 dhe pyetja me nr. 3, nuk janë shënuar ashtu siç i kam parashtruar ashtu që iu ka ndërruar kuptimi, kështu që unë po dal keq para qytetarëve të komunës. Në f. 10 kur kam diskutuar në pikën: Informata e DAK, diskutimi im është shënuar më ndryshe nga ajo që e kam thënë.

Kryesuesi i Kuvendit, Kërkoj nga Shemsedin Luzha që t'i sjellë me shkrim Shërbimit të KK vërejtjet në Procesverbal. Meqë nuk ka kush diçka tjetër, atëherë me vërejtjet e z. Shemsedin Luzha, Procesverbalin e mbledhjes së kaluar të KK e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

APROVOJ

Procesverbalin nga mbledhja e I-r (Parë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2020 të datës 31 Janar 2020 / Lënda: 01Nr. 060/01-2480/20.

Procesverbali do të publikohet në faqen zyrtare të Komunës i korrigjuar.

Pyetjet dhe Kërkesat

Kryesuesi i Kuvendit- Kemal Mërseli, Para se me kaluar në pyetjet dhe kërkesat e juaja, unë e kam një Kërkesë për anëtarët e Kuvendit të Komunës. Tani hyjmë në muajin Mars, muaj ky ku duhet të deklarohet pasuria sipas akteve ligjore që rregullojnë këtë fushë. **Kërkoj nga anëtarë e Kuvendit të Komunës të deklarojnë pasurinë, pasi afati për deklarimin rregullt vjetor të pasurisë është nga data 01-31 Mars 2020, në të kundërtën pasojnë masat ligjore për moszbatimin e këtij afati të përcaktuar ligjor.**

znj. Vlora Dalloshi, Të Konkursi për ndarjen e bursave për studentë e komunës, në bazë të kriterëve të aplikuar në konkurs, shihet së janë përjashtuar nga e drejta e konkurrimit studentët e komunës tonë që studiojnë jashtë vendit, si në Maqedoni etj. me çka kujtoj se nuk

është në rregull me u bërë ky përjashtim, kur dihet së ata studentë janë qytetarë të kësaj dhe taksat ia paguajnë kësaj komune.

znj. Hafize Sallahi, Unë jam anëtare e Këshillit drejtues në Gjimnazin “Skënderbeu në Kaçanik.

1. Në emër të këtij këshillit drejtues dhe këshillit të prindërve të kësaj shkolle, e paraqes një Reagim për një pikë të shitjes së derivateve e cila u ndërtua të udhëkryqi në hyrje të qytetit të Kaçanikut. Shkresa reaguese u lexua nga znj. Sallahu, ndërkaq kërkoj të di nga organet relevante se çka po ndodhë aty në atë pjesë, kush e ka dhënë lejen e ndërtimit të atij objekti. Kërkesa është për marrjen e veprimeve të nevojshme për heqjen e objektit në fjalë nga ai lokacion.

2. Kam një propozim që së paku në dy shkollat e mesme në Kaçanik të bëhet dezinfektimi i objekteve shkollore.

3. Objekti i cili është duke u ndërtuar “Pompa e benzinës” në afërsi të SHM “Skënderbeu” në Kaçanik unë nuk e di sesi do të funksionoj ai objekt, kur dihet së i njëjti është përballë udhëkryqit të qytetit në Kaçanik, ndërkaq rregullat e ndërtimit sipas ligjit në fuqi, i përcaktojnë qartë kushtet dhe kriteret e ndërtimit të objekteve të pompave të benzinës.

z. Selim Reka, A është e vërtetë së është hequr tatimi në tokë dhe nëse nuk është hequr, a duhet të paguhet për të gjitha tokat bujqësore apo vetëm për ato toka që nuk punohen.

z. Adnan Reka, Në mbledhjen e kaluar z. Selim Reka kërkoj nga organet përgjegjëse të komunës t’i ofrojnë një Informatë me shkrim për një shumë të mjeteve buxhetore të cilën e ka paguar komuna për një pronë në afërsi të banesës së madhe në Kaçanik.

Unë prita që këtë informatë ta ndani edhe me ne anëtarët e tjerë të Kuvendit, por ju nuk e bëtë këtë. Meqë ju nuk e bëtë një gjë të tillë, unë kërkoj që kësaj informate t’ia bashkëngjisni edhe informatën për posedim apo mos posedim të lejes ndërtimore, të pompës së benzinës afër gjimnazit ‘Skënderbeu’, dhe këto informacione me shkrim t’i shpërndahen të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Unë kërkoj: shumën që ka paguar apo do të paguaj Komuna për pronën afër banesës së madhe, dhe lejen ndërtimore të pompës së benzinës afër gjimnazit ‘Skënderbeu’.

znj. Kaltrina Tafili,

1. Unë kam një Kërkesë nga f. Duraj për mungesën e ndriçimit publik në rrugën e këtij fshati si dhe i paraqes shqetësimet e tyre për rrugën e ngushtë të fshatit, e cila rrugë vështirëson qarkullimin normal në dy kahe.

2. Një vizitë të cilën i bëmë SHMP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka” në Kaçanik, me anëtarët e Komitetit për Komunitete, ishte shqetësuese çështja e një arome të keqe e cila u ndiente aty, për shkak të kanalizimit. Një tjetër parregullsi që vërejtëm në atë shkollë ishte: Çështja e mbeturinave jashtë objektit të shkollës;

3. Me intereson të di, kur do të fillojnë punimet e objektit që është në gjysmë të SHMP;

4. Në çfarë mënyrë është dhënë në shfrytëzim, ndërtimin i objektit “ Shtëpia e Shpresës” cili organ e ka marrë atë vendim dhe a mund të shfuqizohet ai vendim, sepse ai objekti i ndërtuar nga një OJQ në oborrin e SHMP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka” paraqet pengesë për atë shkollë; dhe

5. Në SHMP nga informatat të cilat i morëm, kuptuam së kishte nevojë për psikolog.

z. Ekrem Kyçyku,

1. Një Kërkesë të cilën e kam ngritur në një mbledhje të KK lidhur me funksionimin e kazinove në mënyrë të kundërligjshme në Komunën e Kaçanikut, ndërkaq nuk kam marrë ndonjë përgjigje nga organet relevante të komunës;
2. Punë kryesi i cili ka fituar tenderin për punimet të cilat janë kryer në rehabilitimin e rrugëve në Kaçanik, nuk ka arritur me i përfunduar punimet në afatin e përcaktuar ligjor. Me intereson të di, a është marrë ndonjë veprim nga komuna për dënimin e kompanisë në fjalë.

z. Hajredin Luta, Kam një vërejtje të komisioni për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale, sepse rruga e fshatit Ivajë i është vendosur emri pa pëlqimin e fshatit. Kërkoj që ky emërtim i kësaj rruge të rishqyrtohet edhe një herë nga komisioni për emërtimin e rrugëve lokale.

znj. Arlinda Rakoci- Raka, Unë kam një propozim që, të shqyrtohet ndryshim plotësimi i Statutit të Komunës të pjesa e komiteteve, sepse Ligji i Vetëqeverisjes Lokale e përcakton ndryshe çështjen e komitetet konsultative dhe komitetet tjera, ndërkaq Statuti i Komunës e përcakton ndryshe. Statuti është kushtetutë e komunës, kështu që duhet vepruar në këtë drejtim sa më parë që është e mundur në ndryshim plotësimin e tij.

z. Shemsedin Luzha,

1. Paraqes një Kërkesë të fshatit Elezaj lidhur me gjendjen e mjerueshme të tualeteve në shkollën e fshatit;
2. E ngriti një Kërkesë të lagjes Harunaj të fshatit Begracë për një ndërtimin e një korite të ujit, për me qarkulluar uji gjatë të reshurave atmosferike, në mënyrë që mos me vërshuar tokat bujqësore në atë pjesë;
3. Rruga që lidhet me Vitinë dhe Fushën Pajtimi- Çardak, është kërkesë e bizneseve të vogla dhe të mesme. me u rregulluar me ndriçim publik, me trotuar me të gjitha dhe më bazë.
4. Të pompa e benzinës e cila u përmend së është duke u ndërtuar në Kaçanik, edhe unë i kam vërejtjet e mia; Pompa nuk guxon me u nderuar në atë lokacion, sepse sipas akteve në fuqi që e rregullojnë këtë fushë, rezervuarët e benzinës nuk guxon të jetë nën objekt fizik siç është duke u ndërtuar ai objekt.
5. Nuk jam i kënaqur me përgjigjen e DAK lidhur me një kërkesë të cilën e kam ngritur për në një mbledhje të KK dhe me një përgjigje të cilën ma ka dhënë DAP.

znj. Nazife Krasniqi, Kërkesa ime është që krejt shkollave të komunës me iu kushtuar rëndësi inspektori sanitar, ashtu që me u bërë dezinfektimi i të gjitha objekteve shkollore ,me qëllim të shmangies së mundësisë së shfaqjes së virusit Covid-19, si dhe me qenë në gjendje gatishmërie me pajisje të nevojshme kundra këtij virusi.

Kryesuesi i Kuvendit, Pyetje e Kërkesa të tjera nuk ka, besoj së përgjigjet do t'i merrni nga ekzekutivi i komunës, ndërkaq konstatoj me vazhduar me pikët tjera të rendit të punës sipas radhës:

3. Propozim Rregullorë për Taksat Komunale;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, kjo çështje është shqyrtuar edhe në KPF dhe e njëjta i ka kaluar KK në procedurë të debatit publik me qytetarë të komunës. Prezent në mbledhje është edhe Shqipe Arifaj nga Asociacioni i Komunave të Kosovës të cilët kanë punuar në draft rregulloren, i cili draft do të jetë i njëjtë për të gjitha komunat, duke ia

përshtatur secila komuna specifike të saj. Fjalën e ka znj. Shqipe Arifaj, zyrtare ligjore në AKK.

znj. Shqipe Arifaj – zyrtare ligjore nga Asociacioni i Komunave të Kosovës- Pasi përshëndeti të gjithë pjesëmarrësit e këtij takimi, theksoj se synimi ynë si asociacion është me bërë unifikim të taksave komunale, sepse ka shumë laramani në nivele komunale të taksave. Disa taksa komunale duhet të mblidhen aq sa për tu paguar ajo çka shpenzohet, koha e humbur, letra e kështu me radhë. Për hartimin e draftit e kemi pasur edhe një udhëzues sesi me hartuar rregulloren. Kolegjiumi ligjor i AKK merret me hartimin e draft rregulloreve, me çka jemi duke punuar edhe drafte tjera të rregulloreve komunale. Drafti pas miratimit shkon në shqyrtim ligjor të ministrisë së linjës –Ministrisë së Financave -përmes MAPL, ndërkaq e jona është me përcjellë atë procedurë, sepse ka ndodhur kur ministria e linjës rregulloren e ka kthyer të kundërligjshme.

Kryesuesi i Kuvendit, Faleminderit znj. Shqipe,

Ju njoftoj së në KPF kanë dalë disa propozime me u futur në Rregullore, ndërkaq kemi edhe një kërkesë të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara, për me u liruar nga disa taksa komunale të gjitha kategoritë e PAK. Të bizneset, është edhe kërkesa e PAK, kjo është e realizuar, sepse të gjitha bizneset janë të liruara nga regjistrimi i bizneseve të tyre. Te neni 4 janë të përfshira PAK, ndërkaq duhet të përfshihen PAK pa përjashtim nga lirimi i disa taksave administrative. Fillimisht për sqarime të nevojshme fjalën ka drejtori i DAP, Festim Neziraj.

z. Festim Neziraj, Fillimisht e falënderoj zyrtaren ligjore nga AKK, znj. Shqipe Arifaj për sqarimet të cilat i dha në draft rregullore, ndërkaq shtoj së është mirë që po bëhet një e rregullore e taksave komunale, sepse nga viti 2016 nuk kemi pasur rregullore të taksave komunale. Z. Neziraj foli për draftin në fjalë, punën e komisionit, bashkëpunimin me AKK për draftin në fjalë, procedurat që ka kaluar drafti për me ardhur deri në KK. Propozimi im është: të pasuesi, Vërtetimi i kombësisë, taksa 5 € të neni 7, pika 1. 21, kjo taksë duhet të hiqet krejt, sepse e kemi të vështirë me bërë këtë vërtetim dhe me e realizuar këtë taksë.

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Selim Reka, Të Kërkesat e Komitetit Konsultativ të PAK, Kryesuesi nuk e përmendi lirin e personave me aftësi të kufizuara nga regjistrimi i veturave.

Unë edhe në KPF kam kërkuar të bëhen këto ndryshime:

Të neni 10 pika 1.24, Kërkesa për tërheqjen e nënshtetësisë nga 20 € sa është propozuar, kam propozuar të bëhet 50€. Të neni 15, pika 1. 11, Basene për kultivimin e peshqve, tarifa prej 2 € për m2, kam propozuar të hiqet krejt kjo taksë. Të neni 7 Kapitulli II, pika 1.19 Vërtetimi që personi nuk është në punë, taksa 1€, kam propozuar të hiqet. Të parkingjet, e kam mbështetur ngritjen e taksës nga 0.20€ në 0.30€. Sa i përket çështjes që thuhet së komuna nuk ka pasur Rregullore të tarifave, rregullore të tarifave kemi pasur, ndërkaq është mirë që po bëhet tani kjo rregullore e re unike për krejt komunat, ndërkaq kërkoj që kjo rregullore të zbatohet në përpikëri.

z. Agim Mani, Të Kapitulli VI, neni 14, propozoj të lirohen nga taksat komunale mbi mjetet motorike, Veteranët e luftës së UÇK-së. Ky pasues të hynë të neni 14 të pika 1.5. Dihet kontributi i veteranëve të UÇK në luftë dhe më këtë lirim nga kjo taksë komunale, unë kujtoj së iu bëjmë një nderë kësaj kategorie me i liruar nga kjo taksë komunale. Komuna e Ferizajt i ka liruar këtë kategori nga këto taksë komunale, ndërkaq lirimi i kësaj kategorie nga kjo

taksë, unë kujtoj së nuk ndikon shumë në të HVK, diku 3500€ në vit. Nëse nuk kalon ky ndryshim, atëherë unë do të jam kundër aprovimit të draft rregullores së taksave komunale.

z. Ekrem Kyçyku, Unë kam kërkuar në mbledhjen e KPF të neni 8, pagesa e taksave për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare, të lirohen nga këto taksa edhe ish të burgosurit politik, sepse me këtë lirim iu bëjmë nderë kësaj kategorie. Të taksat për ndërrimin e destinimit të tokat bujqësore të klasës 1-4, nga 1€ sa është propozuar, kam propozuar të bëhet taksa 2€ për m2. Të neni 26 pika 1.28, kam kërkuar që taksa për vendosjen e foltoreve telefonike, 150€ në vit, të hiqet krejt kjo taksë, sepse nuk besoj së do të ketë më foltore telefonike.

z. Nexhat Loku, Ne si Grup parlamentar i PDK jemi me u hequr disa nga tarifat e propozuara, ndërkaq të propozimi për me u hequr tarifa për nxjerrjen e vërtetimit që personi nuk është në punë, tarifa 1€, nuk pajtohem me u hequr kjo taksë.

z. Ekrem Raka, Unë nuk jam i mendimit me bërë lirime selektive. Propozimi im është me u liruar nga pagesa e taksave komunale administrative: Personat me asistencë sociale dhe Personat me aftësi të kufizuara. Të Kapitulli IV, neni 10 pika 1.4 Kurorëzimi jashtë objektit të komunës dhe jashtë orarit të punës, propozimi im është që kjo taksë nga 30 € sa është propozuar, të bëhet 50 €.

Kryesuesi i Kuvendit, Unë jam me kaluar propozimet e Ekrem Kyçyku dhe të Selim Reka të cilët i kanë dhënë në KPF.

Kryetari i Komunës, Edhe unë pajtohem me mendimin e z. Ekrem Raka që mos të bëjmë lirime selektive të taksave, sepse unë nuk e di sesi mund të mbijetoj komuna nëse i heqim të gjitha taksat e propozuara.

z. Ekrem Kyçyku, Unë pata propozim edhe për ngritje të taksës komunale të ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të klasës 1-4 nga 1€ të bëhet 2€.

z. Selim Reka, Unë tërhiqem nga propozimi që me u liruar nga pagesa e taksës administrative personat që janë pa punë, për nxjerrje të vërtetimit taksa prej 1€, me kusht që të hynë propozimet të cilat i theksova më herët: ngitja e tarifës për tërheqje të nënshtetësisë nga 20€ të bëhet 50€ dhe lirimi nga tarifa të baseneve për kultivimin e peshqve 2€ për m2.

znj. Arlinda Rakoci- Raka, Unë jam për me u liruar nga tarifat dhe ngarkesat të gjitha pikat që ka propozuar Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara.

Kryesuesi i Kuvendit, Mendimi për ngritjen e tarifave për tërheqjen e nënshtetësisë nga 20€ në 50€ është e arsyeshme. Të lirimi i tarifave të PAK, të ish të burgosurve politik, të basenet për kultivimin e peshqve, veteranët të UÇK të shqyrtojmë propozimet të cilat u dhanë. Të Veteranët, lirimi nga tarifat e propozuara, kjo donë një analizë sesa ndikon në të HVK

znj. Lirije Luta, Unë jam me u liruar veteranët e luftës së UÇK nga disa tarifa dhe ngarkesa, PAK mos me u kategorizuar, por me u liruar pa përjashtim, Në f. 13. Pika 1.28 është një gabim të vendosja e foltores me shkrim është 150, ndërkaq me numër është 250. Ka edhe disa gabime të tjera të këtij lloji. Të gjrobat është një gabim i tillë.

Kryetari i Komunës, Propozimet e juaja unë i përkrahi, mirëpo çështja është sa ndikojnë në buxhetin e komunës. Sa i përket propozimit për çështjen e veteranëve, kjo donë një analizë

dhe pas analizës, nëse nuk ndikon shumë në buxhet, mundemi në të ardhmen me ndryshuar dhe plotësuar.

z. Ekrem Raka, Unë kërkoj të merren parasysh edhe propozimet e mia që i potencova në rregullore, e jo vetëm ato që u thanë nga anëtarët, Selim Reka e Ekrem Kyçyku.

Kryesuesi i Kuvendit, Të veteranët, unë nuk jam këtë herë me u hequr taksat pa pasur një analizë, Të ndërrimi i desinimit të tokës bujqësore të klasës 1-4 nuk jam më u ndryshuar taksa e përcaktuar. Edhe taksa për vendosjen e foltores telefonike dhe taksa e përcaktuar të basenet për kultivimin e peshqve nuk jam për me u hequr këto tarifa.

Meqë nuk ka diskutime të tjera, atëherë, me ndryshimet si vijon:

-Heqjen e taksës për vërtetimin e kombësisë neni 7, pika 1.21.

-Të lirimi nga taksat të neni 8, pasuesit: 1.3 Personat e verbër dhe 1.4 personat paraplegjik dhe tetraplegjik, fuzionohen më një pikë me tekstin, personat me aftësi të kufizuara,

-Të lirimin nga taksat të neni 8, shtohet pasuesi, ish të burgosurit politik,

-Të neni 10, Kurorëzimi jashtë objektit dhe jashtë orarit të punës, nga 30€ të bëhet taksa 50€.

-Të neni 10, pika 1.24 – të kërkesa për tërheqje të shtetësisë, taksa nga 20 € bëhet 50€,

-Të neni 11, pika 1.3, pasuesi personat e verbër, të zëvendësohet me pasuesin, Personat me aftësi të kufizuara,

-Të neni 20, të lirimi nga taksat komunale si në këtë pasues, të shtohet edhe pika 1.6. Me tekstin, Ndërtimet për banim social për persona me aftësi të kufizuara.

-Të neni 25, Shtohet pika 10 me tekstin "Kategoria e personave me aftësi të kufizuara lirohen nga pagesa; dhe

-Korrigjimet teknike në tekst të tarifave në shifra dhe fjalë.

Draft Rregulloren e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me shumicën absolute të votave Për, Kundër votë nuk pati, Abstenuan 5 anëtarët nga LVV. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

Aprovoj

Rregullore për Taksat Komunale / Lënda 01Nr.02-60/01-4863/20 / Lënda: 01Nr. 02-60/01-4863/20.

3. Raporti i Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2019;

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka në këtë pikë, e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Unë kam bërë krahasime të Raportit 2019 me Planin e punës për vitin 2019, dhe kam vërtetuar se objektivat e paraqitur nuk shënohen në këtë raport se janë realizuar. Të DUKMM, përmenden disa projekte në planin e punës, ndërkaq nuk janë shënuar në pjesën e raportit të kësaj drejtorie si të realizuara. Edhe të DEFZH përmenden në plan disa projekte, ndërkaq nuk janë përfshirë edhe në raportin e vitit 2019 si projekte të realizuara, nuk është shënuar numri i bizneseve që veprojnë në komunën tonë e as numri i punëtorëve. Të DBPZHR përcjellja dhe monitorimi i prerjes së pyjeve, ky realizim shihet së është i vitit 2015. Gjithashtu në raport e kësaj drejtorie nuk përmenden sipërfaqet e zhveshura. Të pyjeve të komunës. Të DAP nuk është e vërtetë se janë pajisur me fletëdalje të gjithë punëtorët e administratës. Të DSHMS, janë bërë vetëm 6 mostra uji, e që është pak për komunën tonë për 1 vit.

z. Ekrem Raka, Teatri i qytetit të Kaçanikut, është shqetësuese pse nuk është realizuar deri me tani ky projekt.

z. Selim Reka, Materiali është i gjerë. Nga raporti shihet se janë realizuar shumë projekte, ndërkaq realizimi i tyre është i dobët, sepse nuk po shkon shumë kohë e po paraqitën probleme në projektet e realizuara. Të inspektorati është punuar pak me tepër sivjet, ndërkaq të DBPZH, masa drusore e konfiskuar është e vogël në raport me shkatërrimin e pyjeve.

z. Shemsedin Luzha, Unë të inspektori sanitar, nuk e kam ditur deri me tani se ka komuna inspektor sanitar, sepse nuk ka pasur ndonjë reflektim që me u kuptuar.

z. Bahri Selimi, Të DEFZH, planet janë paraqitur si të veçanta, ndërkaq të raporti janë paraqitur realizimet si tërësi. Unë nuk e kam përfshirë realizimin e projekteve, sepse pjesa dërmuese e projekteve janë në kuadër të DSHPE.

Kryesuesi i Kuvendit, Raporti është sa për informimin tuaj, kështu që konstatoj së Kuvendi i Komunës u,

Njoftua

Me Raportin e Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2019 / Lënda: 01Nr. 104/02-5310/20.

4. Raport (Informatë) i punës së Njesisë së Personelit për periudhën: Janar-Dhjetor 2019;

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka në këtë pikë, e hapi diskutimin:

z. Adnan Reka, Unë nuk kam çfarë të them më tepër për këtë raport nga personeli, përveç të them se për punësime në administratën publike jeni kampion, dhe nuk besoj që ka kush që mund t'ua kaloj. Administrata jonë komunale për çdo vit rifreskohet me 'specialistë' duke i punësuar fillimisht për shërbime të veçanta e më pastaj duke përfunduar me kontrata të përhershme. Vitin e kaluar kishim 22 të punësuar për shërbime të veçanta (kontratë mbi vepër), ndërsa këtë vit kemi 19 të punësuar për shërbime të veçanta, do të thotë 3 më pak se vitin e kaluar, por jo! Sepse numri i përgjithshëm i të punësuarave nga viti kaluar është rritur nga 121 të punësuar në 125, pa llogaritur ata që janë pensionuar apo ata që janë larguar me dëshirë. Do të thotë ky është zhvillimi ekonomik i komunës tonë, që buxhetin komunal e orienton në paga dhe mëditje duke e rritur administratën publike për çdo vit.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nga viti 2012 në organizatën buxhetore të komunës tonë janë të punësuar 801 punëtorë. Sa i përket punësimeve me Kontratë në vepër, lirisht mund të themi se jemi komuna që më së paku kemi bërë punësime të tilla dhe ato punësime kanë qenë shumë të nevojshme. Si shembull për punësime me Kontratë në vepër z. Adnan mundesh me marrë komunitat që i udhëheq partia e juaj- LVV.

z. Adnan Reka, Replikë- E para, mua nuk më intereson shumë për komunitat tjera sepse unë jam këshilltar i zgjedhur në këtë kuvend, çka bëjnë të tjerët në komuna tjera ajo është çështje tjetër. E dyta, unë po i referohem raportit zyrtar çfarë po shkruan, vitin e kaluar ishin të punësuar 121 punëtorë, këtë vit keni 125, dhe kjo është rritje, dhe tjetra, kontratë për shërbime të veçanta, vet fjala kontratë për shërbime të veçanta tregon që kjo kontratë është për shërbime të veçanta dhe ka një afat kohor të caktuar me ligj, 1, 3 apo 6 muaj dhe pastaj kjo kontratë përfundon.

Kryesuesi i Kuvendit, Numrin e të punësuarve e kemi edhe të raporti i financave. Diskutime të tjera nuk ka, ky raport pune i është drejtuar KK sa për informimin, kështu që konstatoj së Kuvendi i Komunës u,

Njoftua

Me Raportin (Informatë) i punës së Njesisë së Personelit për periudhën: Janar-Dhjetor 2019 / Lënda: 01Nr. 104/02-230/20.

5. Raporti Vjetor Financiar për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2019;

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka , e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Ky raport është pak më ndryshe nga raportet e viteve të tjera financiare, sepse ishte me vetëm 30 faqe nga 59, ndërkaq me kërkesën tonë në KPF para dy ditëve na u dërgua raporti i plotë. Nga raporti, shihet se HVK janë realizuar 70%, si rezultat i të hyrave indirekte. Vërejtjet e mia janë: mosrealizimi i gjobave nga inspektorati dhe taksave për shfrytëzimin e resurseve natyrore Nga shfrytëzimi i resurseve natyrore shihet se nuk kemi asnjë të hyrë buxhetore.

Nuk kemi tabelar mbi shkallën e realizimit të buxhetit, më intereson të di, sa janë mjetet buxhetore nga Granti qeveritar të pa shpenzuara, sa janë të pashpenzuara nga huatë, sa janë mjete të pashpenzuara nga donacionet, sa është shkalla e realizimit nga mjetet e alokuara sa është buxheti dhe realizimi në përgjithësi.

z. Bahri Selimi, Unë në mbledhjen e KPF kam pasur kërkesa se na është dërguar raporti në formë të shkurtër, ndërkaq në bazë të atyre kërkesave ua kam dërguar raporti ashtu siç është hartuar në bazë të standardeve ndërkombëtare për menaxhimin e financave publike.

Lidhur me shpenzimet për udhëtime jashtë vendit, më rastin e vizitës në Shqipëri të anëtarëve të KK, ia kam dërguar të dhënat Kryesuesit të KK, sepse këto mjete janë regjistruar si trajnime. Gjithashtu ua kam dërguar një listë me të HVK sipas drejtorive. Në vazhdim z. Selimi i dha me shifra e përqindje inkasimet e të HVK sipas drejtorive, DEFZH, 90%, DSHPE, ka regres, sepse ka realizuar 60% të mjeteve nga planifikimi, DBPZHR, 64%, DAK, 60%, DSHMS, ka rënie në inkasim, DAP ka ngritje, inkasimi është 58%,

Të Mallrat dhe Shërbimet mjetet buxhetore nuk janë realizuar sesa janë planifikuar vetëm për 2%, janë kthyer 116€. Shpenzimet komunale për 5%, Subvencionet dhe transferet, për 1%, Të GQ janë 118€, Huaja, 674, të paalokuara 6122, të bartura, 127.000, shumat nga donacionet. Pagat dhe mëditjet kanë shënuar rritje krahas rritjes së gjidipisë dhe shumat na i qesin me buxhet diku 200-300 mijë euro më tepër. Pagat na kanë mbetur, sepse nuk kemi pasur rishikim buxhetor, Ligji i pagave është pezulluar, kështu që na kanë mbetur mjete të planifikuara. Çështja e pagesës së komisioneve, është përmendur se disa komuna i paguaj komisionet, mirëpo kjo nuk qëndron sepse komisionet nuk paguhen. Me ligj, ne jemi mirë sa i përket pagesës së komisioneve, unë jam konsultuar me nivelin qendror, ata me kanë thënë ashtu si Kryetari i Komunës që formon komisione, formon edhe Kuvendi i Komunës, por nuk paguhen. Unë e kam dërguar edhe një Shkresë zyrtare në MEF ku kam kërkuar mendim profesional, ata me kanë thënë se me Udhëzimi Administrativ 16/2008 –për pagesën e stafit politik në komuna, paguhen vetëm komitetet obligative të KK., ndërkaq presim përgjigjen me shkrim nga kjo ministri lidhur me shkresën e dërguar. Në vazhdim drejtori lexoj dispozita ligjore që rregullojnë çështjen e pagesës së komiteteve obligative të KK. Tjetër: Vendimet e gjykatave na kanë shkaktuar funksionim jo të mirë të komunës. Këto vendime edhe pse i kemi prapësuar, të gjitha na janë kthyer dhe janë ekzekutuar me përmbaues privat.

znj. Arlinda Rakoci-Raka, Më intereson se ku jeni bazuar para një viti për pagesën e komisioneve, kur dihet fakti se unë si anëtare e komisionit për ndryshime të statutit të komunës jam paguar.

z. Bahri Selimi, Nëse ne e bëjmë një gabim sot, nuk bënë të përsërisim nesër, sepse mund të vjen puna që për gabimet tona të shkojmë në përgjegjësi. Ne e kemi pasur një shkresë të MEF ku na është tërhequr vërejtje për këtë çështje.

Kryesuesi i Kuvendit, Neni 80 të LFPP, nuk ka të bëjë me pagesën e anëtarëve të KK. Me ligj, kompensimet të cilat i marrin anëtarët e KK nuk mund të quhen pagë, ndërkaq me ligjin e ri të pagave ajo është diçka tjetër. Me pasur mundësi me gjetur forma me i kompensuar komisionet e KK do të ishte mirë.

z. Adnan Reka, Përveç 824, 638 € në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime të shpenzuara në mënyrë mjaft të paarsyeshme, kemi edhe një fakt tepër shqetësues. Në viti 2017 komuna jonë ka paguar, 178,626 € penallti, ndërsa në vitin 2018 ka paguar 293,500 €, ndërsa në vitin 2019 është dashur të paguaj hiq më pak se 364, 814 € dhe për më tepër, këto penallti që ky ekzekutiv i paguan nga paratë e taksapagueseve më të varfër në Kosovë kanë një trend të rritjes nga viti në vit.

z. Selim Reka, E falënderoj drejtorin e DEFZH Bahri Selimi për sqarimet që i dha. Të HVK realizimi është i mirë, ndërkaq insistimi i komunës është që gjithherë me arritur 100% realizim. Edhe të Granti qeveritar, realizimi i buxhetit është i mirë, ndërkaq shqetësuese janë pagesat për shpenzime kontingjente. Këtu nuk po dihet së kush është fajtori, a është në pyetje zyrtari që bënë vendimet e nuk i harton mirë vendimet apo është faji të avokati publik i komunës së nuk po mundet me e mbrojtur komunën. Unë mendoj së dikush duhet me shkuar në përgjegjësi për këto vendime, sepse buxheti i komunës po shkon në llogari të individëve të caktuar e jo në llogari të interesave shoqërore.

z. Besim Vishi, Për herë të parë shihet se në vitin 2019 të HVK janë tejkaluar, mirëpo tejkalimi është nga realizimi i të hyrave indirekte-të hyrat nga gjobat që realizohen me vendime të gjykatave për shkak së gjobat në trafik. po shqiptohen shumë shpesh qytetarëve të komunës tonë. Të pylltaria, këtu nuk kemi shumë të HVK, ndërkaq pyjet po shkatërrohen më të madhe. Të çështja e shpenzimeve kontingjente, më intereson të di, ku është leverdia e komunës lidhur me pronën që ia ka kompensuar Rizah Tusha, për një pronë që nuk e shfrytëzojmë, kur dihet se është një shumë e madhe e mjeteve buxhetore të cilën komuna duhet me ia paguar këtij personi për atë pronë. Unë nuk e di ku është faji, a është të avokati publik i komunës së nuk po mundet me i mbrojtur kontestet apo është faji diku tjetër. Të pagesat e komisioneve, drejtori dha sqarimet e nevojshme, ndërkaq duhet kërkuar informata të nevojshme edhe në asociacion apo të ndonjë mekanizëm tjetër sesi me vepruar për me i kompensuar komisionet, sepse ne për me ardhur në mbledhje të komisioneve, po kemi edhe shpenzime dhe humbje të kohës.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Të shpenzimet kontingjente, janë shpenzimet e krijuara nga kontestet e humbura gjyqësore, të cilat mjete janë paraparë në vitin 2018 me u realizuar, por nuk janë realizuar në vitin e paraparë, por kanë ngelë barrë në vitin 2019. Shuma e mjeteve për shpenzime kontingjente për kontestin e humbur me rastin Tusha, është 513.000€. Unë kam kërkuar që prona t'i kthehet palës, por gjykata ka vlerësuar se janë zhvilluar të gjitha procedurat paraprake dhe nuk ka kthim prapa. Avokati publik i komunës është duke u munduar me kryer punën e vet. Unë nuk mundem me thënë ndoshta se nuk janë më të mirët zyrtarët e komunës tonë, por jo edhe më të këqijtë. Unë nëse marrë veprime me hequr ndonjë zyrtar të komunës, nuk shkon 5-6 vite dhe gjykata ma kthen përsëri në punë me të gjitha kompensimet. Këtë po e themi, sepse deri me tani, çdo punëtor të larguar gjykata e ka kthyer në punë.

z. Bahri Selimi, Të HVK, jemi mirë të ato direkte, ndërkaq tejkalimi është të HVK indirekte. Të çështja e pagesës së komisioneve, duhet pritur interpretimin ligjor nga MEF.

z. Besim Vishi, Të hyrat indirekte, nga unë kujtoj se duhet ndikuar Kryetari i Komunës Besim Ilazi tek Policia e Kosovës, në mënyrë që ta kenë parasysh faktin, përse ka kaq shumë dënime në komunën tonë të gjobave në trafik.

z. Ekrem Raka, Shuma e mjeteve të shpenzuara për mbeturina për një vit, 30.000€, kujtoj së është një shumë bukur e madhe e shpenzimeve buxhetore për një vit. Të detyrimet e papaguara, nga raporti shihet së kanë ngelë barrë e buxhetit 2020 shumë detyrime të papaguara të viteve paraprake.

z. Bahri Selimi, Të detyrimet e papaguara, janë detyrimet të cilat kanë ngelur nga viti 2018. Një e kemi të shëndetësia-Furnizimi me rëntgen, materiali nuk na ka ardhur më kohë, kështu që ka ngelë detyrim i pa paguar. Të mbeturinat, janë marrëveshje me KRM “Pastërtia” për 1 vit për institucionet publike, ndërkaq shqetësimi ynë është të çështja e energjisë elektrike.

z. Shemsedin Luzha, Unë e shoh në shumë kompetenca të DUKMM sepse janë paksa të përziera me DSHPE. Kur jemi të projektet kapitale, pavarësisht ankesave të qytetarëve, sa herë del keq qytetari dhe jo komuna, d.m.th sa herë e mira reflekton në interes të institucionit e jo të qytetarit.

Kryesuesi i Kuvendit, Raporti financiar nuk votohet, kështu që konstatoj së Kuvendi i Komunës u ,

Njoftua

Me Raportin Vjetor Financiar për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2019 / Lënda: 01Nr. 05-400/01-4908/20.

6. Raporti i Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2019;

Kryesuesi i Kuvendit, Raporti është hartuar nga KPF në bashkëpunim me zyrtaren e KK, Makfire Malsiu. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë raport pune e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Aprovimin e Raportit të Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2019 / Lënda: 01Nr. 60/01-5004/20.

7. Raporti i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2019;

Kryesuesi i Kuvendit, Raporti është hartuar nga Komiteti për Komunitete. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

znj. Kaltrina Tafili, Komiteti për Komunitete është komitet obligativ njëjtë si KPF. Unë kam një Ankesë për mospjesëmarrjen e anëtarëve të Ekzekutivit të Komunës në mbledhje të komitetit për komunitete. Për kundër faktit se, ne i ftojmë në mbledhje drejtorët e drejtorive, ftesës tonë nuk i përgjigjen. Nëse ne kemi ndonjë çështje për ndonjë drejtor drejtorie, nëse nuk merr pjesë drejtori në mbledhje të këtij komiteti, nuk po kemi kujt me iu drejtua në mbledhje, kështu që mbledhja po del e varfër. Unë kërkoj që në mbledhje të këtij komiteti të

marrin pjesë drejtorët e drejtorive që i adresohet çështja apo se paku nëse janë të nxënë të dërgojnë në mbledhje ndonjë përfaqësues të tyre.

Kryesuesi i Kuvendit, Pjesëmarrja në mbledhje të komiteteve të KK është e obligative, Nëse nuk ka kush diçka, atëherë këtë raport pune e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Aprovimin e Raportit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2019 / Lënda: 01Nr. 060/01-5452/20.

8. Propozim Vendimi për ndryshim plotësimin e vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 60/01-36810/19 të datës 29.11.2019;

Kryesuesi i Kuvendit, Ndryshimet duhet të bëhen në vendim të KK për formimin e komisionit vlerësues, për shkak së një anëtar nga ekzekutivi i komunës ka shkuar në pension (Remzi Shabani), kështu që është propozuar të zëvendësohet me anëtarin, Bujar Dullovi-inspektor në DUKMM. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë Propozim Vendim e shtroj në votim dhe i njëjti u aprovua me 22 votë Për, Kundër votë nuk pati, Abstenuan 4 anëtarë. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për ndryshim plotësimin e vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 60/01-36810/19 të datës 29.11.2019 për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale, ashtu që nga komisioni vlerësues, hiqet anëtari nga ekzekutivi i komunës, Remzi Shabani për shkak të pensionimit të parakohshëm, ndërkaq në vend të tij caktohet, Bujar Dullovi / Lënda: 01Nr. 104/02-3037/20.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu që mbledhja i përfundoj punimet në ora 15:30. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 26 anëtarët të cilët ishin prezent në mbledhje.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Makfire Malsiu



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli

Kemal Mërseli